



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

GRUPI PARLAMENTAR I PARTSË SOCIALISTE

Nr. ____ Prot .

Tiranë, më ____ .2021

Lënda : Depozitim projektligji

Drejtuar:

**Z. GRAMAZ RUÇI
KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË**

I nderuar Z.Kryetar,

Bazuar në nenin 81 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe nenit 68 të Rregullores së Kuvendit, Ju paraqes projektligjin "DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN Nr. 7905, datë 21.3.1995 "KODI I PROCEDURËS PENALE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR"

DEPUTETI PROPOZUES

ULSI MANJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. ____ / 2021

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN Nr. 7905, datë 21.3.1995 “KODI I PROCEDURËS PENALE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 81, pikat 1 dhe 2, shkronja “d”, 83, pika 1 dhe 135, pika 3 të Kushtetutës, me propozimin e _____,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 14, pika 4, ndryshohet si më poshtë:

“4. Gjykimet për kërkesat e parashikuara në pikën 2, të nenit 13, të këtij Kodi shqyrtohen nga një gjyqtar i vetëm.”.

Neni 2

Neni 14/a ndryshohet si më poshtë:

“Neni 14/a

Gjykata e Lartë dhe përbërja

Gjykata e Lartë gjykon në kolegje me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë. Gjykata e Lartë gjykon njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore në kolegje me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë dhe ndryshimin e praktikës gjyqësore në kolegje të bashkuara.”.

Neni 3

Në nenin 15, pika 2, fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:

“Nuk mund të marrë pjesë në gjykim gjyqtari që ka shqyrtuar kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake ose në seancë paraprake për të njëjtin procedim, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Kod.”.

Neni 4

Në nenin 21, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Për kërkesën e përjashtimit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë vendos një gjyqtar tjetër i kësaj gjykate, i ndryshëm nga gjyqtarët e kolegjit të cilit i përket gjyqtari që kërkohet të përjashtohet. Vendimi është i formës së prerë.”.

Neni 5

Në nenin 22, pika 4, fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë:

“Kundër tij mund të bëhet ankim së bashku me vendimin përfundimtar.”.

Neni 6

Pas nenit 22 shtohet neni 22/a me këtë përmbajtje:

“Neni 22/a

Sanksione për kërkesën e deklaruar të papranueshme

Vendimi që deklaron të papranueshme kërkesën e përjashtimit ose që nuk pranon përjashtimin e gjyqtarit, përmban shpenzimet gjyqësore përkatëse, si dhe një gjobë deri në 50 000 lekë, në ngarkim të palës që, duke abuzuar, ka parashtruar një kërkesë të padrejtë.”.

Neni 7

Në nenin 75/a, shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) krimet e parashikuara nga nenet 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a, 234/b, 244, paragrafi 2, 244/a, 245, 245/1, paragrafi 2 dhe 4, 257, 258, paragrafi 2, 259, paragrafi 2, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh, 319/e, 328 dhe 328/b të Kodit Penal;

Neni 8

Në nenin 249, pika 1, pas togfjalëshit “për caktimin e masës së sigurimit” shtohet togfjalëshi “mospranimin ose rrëzimin e saj”.

Neni 9

Në nenin 264, pika 1, fjalia e fundit ndryshohet si më poshtë:

“Kundër vendimit mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit.”.

Neni 10

Në nenin 291 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pas pikës 2, shtohet pika 2/1 me përmbajtjen si vijon:

“Ankimi i njoftohet menjëherë prokurorit dhe palëve të tjera.”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Ankimi shqyrtohet nga gjyqtari që gjykon kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake në dhomë këshillimi, brenda 30 ditëve nga depozitimi në sekretarinë e gjykatës të kopjes së akteve që përmban fashikulli i vendimit të mosfillimit të procedimit. Prokurori, jo më vonë se 15 ditë nga paraqitja e ankimit, i dërgon gjykatës një kopje të akteve që përmban fashikulli i vendimit të mosfillimit si dhe ka të drejtë të paraqesë parashtrime me shkrim lidhur me bazueshmërinë e ankimit.”.

3. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Kundër vendimit palët mund të bëjnë ankim në gjykatën e apelit brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit. Gjykata e apelit shqyrton ankimin në dhomë këshillimi brenda 30 ditëve nga data e marrjes së akteve.”

Neni 11

Në nenin 318, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 2 ndryshon si më poshtë:

“2. Kur nuk e pranon kërkesën, prokurori merr vendim të arsyetuar dhe njofton personin viktimë, i cili mund të bëjë ankim në gjykatë, brenda 5 ditëve nga njoftimi i vendimit. Ankimi i njoftohet menjëherë prokurorit.”.

2. Pas pikës 2, shtohet pika 2/1 me përmbajtjen si vijon:

“2/1. Ankimi shqyrtohet nga gjyqtari që gjykon kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake në dhomë këshillimi, brenda 5 ditëve nga depozitimi i ankimit në sekretarinë e gjykatës. Prokurori, jo më vonë se 2 ditë nga njoftimi i ankimit, mund të paraqesë parashtrime me shkrim lidhur me bazueshmërinë e ankimit dhe të depozitojë prova në mbështetje të tyre.”.

Neni 12

Në nenin 320, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1, pas togfjalëshit “gjkata merr vendim” shtohet togfjalëshi “në dhomë këshillimi”.

2. Në fjalinë e tretë të pikës 1, pas togfjalëshit “shqyrton ankesën” shtohet togfjalëshi “në dhomë këshillimi”.

Neni 13

Në nenin 324, pas togfjalëshit “Vendimi për zgjatjen e afatit të hetimeve” shtohet togfjalëshi “jepet i arsyetuar dhe”.

Neni 14

Në nenin 325, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1, pas fjalisë së parë shtohet fjalia me këtë përmbajtje: “Ankimi i njoftohet menjëherë palëve të tjera.”.

2. Pas pikës 1, shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1 Brenda 5 ditëve nga njoftimi i ankimit, prokurori, i pandehuri ose viktima sipas rastit, mund të paraqesin parashtrime me shkrim lidhur me bazueshmërinë e ankimit, si dhe të depozitojnë prova në mbështetje të tyre.”.

3. Pika 2 ndryshon me përmbajtjen si vijon:

“2. Ankimi shqyrtohet nga gjyqtari që gjykon kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake në dhomë këshillimi, brenda 10 ditëve nga depozitimi i ankimit në sekretarinë e gjykatës.”.

4. Në pikën 4, pas fjalisë së parë shtohet fjalia me përmbajtjen si vijon:

“Gjkata e apelit shqyrton ankimin në dhomë këshillimi, brenda 10 ditëve nga depozitimi i ankimit në sekretarinë e gjykatës.”.

Neni 15

Në nenin 332, para pikës 1 shtohet një pikë me këtë përmbajtje:

“1. Kërkesa për dërgimin e çështjes në gjykim shqyrtohet në seancë paraprake nga gjyqtari i vetëm. Kërkesat për dërgimin në gjykim të çështjeve të ndara nga i njëjti procedim penal, shqyrtohen nga i njëjti gjyqar i seancës paraprake.”.

Neni 16

Në nenin 332/a, pas pikës 3 shtohet pika 4 si më poshtë:

“4. Kur i pandehuri në gjendje të lirë, me gjithë kërkimet, sipas neneve 140-142 të këtij Kodi, nuk paraqitet në seancën paraprake dhe rezulton se nuk ka marrë dijeni personalisht për gjykimin, gjykata vendos sipas pikave 1, 2, 3 ose 4, të nenit 352 të këtij Kodi.”

Neni 17

Në nenin 332/dh, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1, shkronja “b” ndryshohet si vijon:

“b) vijimin e gjykimit nga e njëjta gjykatë, kur palët paraqesin marrëveshje mbi kushtet e pranimit të fajësisë dhe caktimin e dënimit;”.

2. Në pikën 1, shkronja “c” ndryshohet si vijon:

“c) të ftojë palët të paraqesin diskutimet përfundimtare, kur i pandehuri ka kërkuar gjykimin e shkurtuar, pasi kryen verifikimin mbi gjendjen e akteve, sipas parashikimeve të nenit 332/c të këtij Kodi. Palët kanë të drejtë të kërkojnë një afat për t’u përgatitur, jo më të gjatë se 15 ditë.

Kur i pandehuri akuzohet për kryerjen e një vepre penale për të cilën parashikohet dënim me burgim në maksimum mbi 10 vjet, gjykata cakton datën e seancës dhe njofton kryetarin për të kryer plotësimin e trupit gjykues, sipas ligjit.”.

2. Në pikën 1, pas pikës “ç”, shtohet pika “d” me këtë përmbajtje:

“d) deklarin e moskompetencës dhe dërgimin e çështjes në gjykatën kompetente, në rastet e parashikuara në ligj.

Neni 18

Në nenin 384, pika 3 shfuqizohet.

Neni 19

Në nenin 406/dh, pika 1, fjalia e dytë ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Kur marrëveshja paraqitet në seancën paraprake, gjykata vendos sipas parashikimeve të nenit 332/dh, pika 1, shkronja “b”, të këtij Kodi.”.

Neni 20

Në nenin 386, pika 2, në fjalinë e parë, togfjalëshi “që nuk kanë qenë të pranishme në shpalljen e tij” shfuqizohet.

Neni 21

Në nenin 415 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, fjalia e dytë, togfjalëshi “shpalljes ose” shfuqizohet.
2. Në pikën 2, togfjalëshi “arsye të tjera që lidhen me ankimin” zëvendësohet me togfjalëshin “parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim”.

Neni 22

Në nenin 417, pika 1, pas fjalisë së parë, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Në rastet e rekursit, vendimi mund të pezullohet nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vetëm në rastet e parashikuara nga pika 1 e nenit 476 të këtij Kodi.”.

Neni 23

Neni 426 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Neni 426

Shqyrtimi i çështjes në apel

1. Gjyqtari relatori i çështjes në gjykatën e apelit caktohet me short.
2. Gjyqtari relator cakton datën dhe orën e gjykimit në përputhje me kalendarin e shqyrtimit të çështjeve, duke marrë për bazë radhën, sipas kohës së ardhjes së dosjes në gjykatën e apelit. Kanë përparësi në shqyrtim çështjet në lidhje me ekstradimet për jashtë shtetit, çështjet në të cilat i pandehuri është i paraburgosur dhe çështjet për të cilat Gjykata e Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë.
3. Gjyqtari relator i çështjes urdhëron thirrjen e të pandehurit, paditësit civil dhe të paditurit civil, si dhe të mbrojtësve e të përfaqësuesve të tyre. Afati i paraqitjes nuk mund të jetë më i vogël se dhjetë ditë.
4. Urdhri i thirrjes është i pavlefshëm kur i pandehuri nuk është identifikuar në mënyrë të sigurtë ose kur nuk është saktësuar vendi, dita dhe ora e paraqitjes.”.

Neni 24

Në nenin 426/a bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i dispozitës ndryshon si vijon: “Seanca gjyqësore”.

2. Në pikën 1, togfjalëshi “Përpara se të fillojë shqyrtimin gjyqësor,” zëvendësohet me fjalën “Fillimisht”.

Neni 25

Pas nenit 427, shtohet neni 427/a me këtë përmbajtje:

“Neni 427/a

Gjykimi në apel në dhomë këshillimi

1. Në rastet kur ky Kod parashikon gjykimin në apel në dhomë këshillimi, gjykimi bëhet mbi bazë aktesh dhe/ose dokumentesh.

2. Gjyqtari relator urdhëron njoftimin e palëve, sipas nenit 426, të këtij Kodi. Palët kanë të drejtë që deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes, në dhomë këshillimi, të paraqesin parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në apel dhe apelin kundërshtues.

3. Për çështjen që shqyrtohet me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, relatori përgatit paraprakisht dhe u shpërndan anëtarëve një relacion të përmbledhur të dosjes gjyqësore dhe shkaqeve të ngritura në ankim.

4. Shqyrtimi i çështjes në dhomë këshillimi vijon nëse njoftimet e palëve janë të rregullta.

5. Për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi mbahet procesverbal nga sekretari gjyqësor.”

Neni 26

Në nenin 427, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, togfjalëshi “ose plotësimin e tij,” shfuqizohet.

Neni 27

Në nenin 434, pas pikës 2, shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Në rastet kur Gjykata e Lartë kryesisht vë në diskutim çështje të ligjit, që palët nuk kanë paraqitur më parë mendimin e tyre, përpara shqyrtimit urdhërohet njoftimi i palëve dhe caktohet afati për depozitimin e parashtrësive të tyre mbi çështjet e ligjit. Njoftimi në këto raste kryhet sipas rregullave të përgjithshme.”

Neni 28

Pas nenit 434 shtohet neni 434/a me këtë përmbajtje:

“Neni 434/a

Përmbajtja e rekursit

1. Rekursi duhet të përmbajë:

a) palët ndërgjyqëse;

- b) vendimin që kundërshtohet;
- c) paraqitjen e përmbledhur të fakteve të çështjes;
- ç) shkaqet për të cilat kërkohet prishja e vendimit si dhe argumentet që mbështesin pretendimin se ekzistojnë shkaqe për rekurs sipas parashikimeve të nenit 432 të këtij Kodi;
- d) prokurën e avokatit, në rastet kur rekursi paraqitet nga i pandehuri ose palët private;

2. Rekursi mund të paraqitet në përputhje me formatin e miratuar me vendim të Këshillit të Gjykatës së Lartë.”.

Neni 29

Në nenin 435, pika 1, ndryshon me këtë përmbajtje:

“Rekursi paraqitet me shkrim, brenda 45 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të gjykatës së apelit. Afati për paraqitjen e rekursit kundër një vendimi të gjykatës së apelit me të cilin është vendosur prishja e vendimit dhe kthimi i akteve gjykatës së shkallës së parë, është 20 ditë. Rekursi shqyrtohet nga Gjykata e Lartë jo më vonë se dy muaj nga momenti i regjistrimit të tij ne sekretarinë gjyqësore.”.

Neni 30

Pas nenit 435, shtohet neni 435/a me këtë përmbajtje:

“Neni 435/a

Kundërrekursi

1. Pala kundër të cilës është paraqitur rekurs, mund ta kundërshtojë atë me kundërrekurs brenda 20 ditëve nga dita kur ka marrë njoftimin për rekursin e palës tjetër. Në rastin kur rekursi është paraqitur kundër një vendimi të gjykatës së apelit me të cilin është vendosur prishja e vendimit dhe kthimi i akteve gjykatës së shkallës së parë, afati për paraqitjen e kundërrekursit është 10 ditë.

2. Kundërrekursi i njoftohet atij që ka bërë rekursin brenda 20 ditëve nga komunikimi i rekursit.

3. Për kundërrekursin zbatohen rregullat e parashikuara në nenin 423 të këtij Kodi”.

Neni 31

Në nenin 436, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Gjyqtari relator i caktuar me short vendos datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi në përputhje me rregullat e planifikimit të gjykimit të parashikuara në ligj.

Neni 32

Pas nenit 436 shtohet neni 436/a me këtë përmbajtje:

“Neni 436/a

Shqyrtimi i çështjes

1. Shqyrtimi i rekursit në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi.
2. Gjyqtari relator paraqet relacionin, duke pasqyruar në të, veç të tjerave, edhe përmbajtjen e vendimit të ankimuar, pretendimet dhe shkaqet e ngritura në recurs, prapësimet e paraqitura në kundërrecurs, shqyrtimin e fakteve që kanë rëndësi për marrjen e vendimit dhe propozimin e tij për zgjidhjen ligjore të çështjes.
3. Për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi mbahet procesverbal nga sekretari gjyqësor.”.

Neni 33

Në nenin 437, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se:

- a) çështja paraqet rëndësi nga pikëpamja e së drejtës, për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore;
- b) vlerësohet e nevojshme nga Kolegji Penal thirrja dhe dëgjimi i palëve për shkak të problematikës ose kompleksitetit të çështjes, në rastet e përcaktuar në shkronjat “b” dhe “c”, të pikës 1, të nenit 432, të këtij Kodi.”.

Neni 34

Neni 438 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Neni 438

Njësimi dhe ndryshimi i praktikës gjyqësore

1. Kolegji Penal, kryesisht ose me kërkesë të palëve, mund të vendosë nisjen e procedurës së gjykimit për të njësuar ose ndryshuar praktikën gjyqësore. Nisja e procedurës për ndryshimin e praktikës gjyqësore mund të vendoset edhe nga Kryetari i Gjykatës së Lartë.
2. Vendimi i ndërmjetëm i Kolegjit Penal ose i Kryetarit të Gjykatës së Lartë për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore përcakton çështjet e shtruara për njësim ose praktikën gjyqësore të njësuar që duhet ndryshuar. Vendimi publikohet menjëherë pas arsyetimit, në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë.

3. Gjykimi për njësimin e praktikës gjyqësore bëhet nga Kolegji Penal me trupë gjyqësore prej 5 gjyqtarësh, në të cilën marrin pjesë trupa gjyqësore që po gjykon rekursin dhe dy gjyqtarë të tjerë të kolegjit, të caktuar me short.

4. Gjykimi për ndryshimin e praktikës gjyqësore të njësuar bëhet nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Kryetari i Gjykatës së Lartë, si kryesues i Kolegjeve të Bashkuara, cakton datën dhe orën e gjykimit të çështjes për ndryshimin e praktikës gjyqësore. Kolegjet e bashkuara gjykojnë sipas rregullave të caktuara për kolegjin kur marrin pjesë jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të Gjykatës së Lartë.

5. Data dhe ora e seancës gjyqësore u njoftohen palëve nga sekretaria gjyqësore sipas rregullave të përgjithshme të njoftimit, të paktën 15 ditë përpara datës së zhvillimit të seancës.

6. Kolegji Penal ose Kolegjet e Bashkuara, kryesisht ose me kërkesë të palëve, mund të vendosë ndryshimin e çështjeve të shtruara për njësim ose ndryshim të praktikës gjyqësore. Ky vendim i ndërmjetëm publikohet në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë.

7. Për shkak të interesit që paraqet njësimi ose ndryshimi i praktikës gjyqësore, në këto gjykime, kur është rasti, Gjykata e Lartë mund të kërkojë mendimin me shkrim nga Avokatura e Shtetit, si dhe nga persona juridikë publikë ose privatë që çmohet se kanë njohuri të posaçme mbi çështjet ligjore të shtruara për njësim ose ndryshim të praktikës gjyqësore. Gjykata e Lartë, në kërkesën për paraqitjen e mendimit me shkrim cakton një afat brenda të cilit mund të paraqitet mendimi, i cili në çdo rast nuk mund të jetë më i vogël se 14 ditë. Mendimet me shkrim nuk janë detyruese dhe publikohen në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë.

8. Vendimi i Kolegjit Penal dhe Kolegjeve të Bashkuara është i detyrueshëm për gjykatat në gjykimin e çështjeve të ngjashme.”.

Neni 35

Pas nenit 438, shtohet neni 438/a, me këtë përmbajtje:

“Neni 438/a

Procedimet paragjykimore

1. Nëse Kolegji Penal ose Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, gjatë shqyrtimit të çështjes, në dhomë këshillimi ose në seancë gjyqësore, vendosin t’i drejtohen Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut ose gjykatave të tjera ndërkombëtare, sipas detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, vendosin pezullimin e shqyrtimit të çështjes.

2. Vendimi i pezullimit zgjat deri në marrjen e vendimit nga gjykata ndërkombëtare. Vendimi i gjykatës ndërkombëtare u njoftohet palëve bashkë me datën e seancës.”

Neni 36

Neni 441 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Neni 441

Vendimet e Gjykatës së Lartë

“1. Pas shqyrtimit të çështjes, Kolegji Penal ose Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, vendosin:

a) mospranimin e rekursit, në rastet kur është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikon neni 432 i këtij Kodi;

b) prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë;

c) prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë me tjetër trup gjykues;

ç) prishjen e vendimeve të gjykatës së apelit dhe të gjykatës së shkallës së parë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në shkallë të parë, kur nuk janë respektuar dispozitat që lidhen me kushtet për të qenë gjyqtar në çështjen konkrete, me numrin e gjyqtarëve që është i domosdoshëm për formimin e kolegjeve të caktuara në këtë Kod, me ushtrimin e ndjekjes penale nga prokurori dhe pjesëmarrjen e tij në procedim, me pjesëmarrjen e të pandehurit, të mbrojtësit të tij, ose përfaqësuesit të viktimës akuzuese, me shkeljen e dispozitave për paraqitjen e akuzave të reja, si dhe në çdo rast kur në dispozita të veçanta është parashikuar pavlefshmëria e vendimit;

d) prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së apelit dhe pushimin e gjykimit të çështjes pa e kthyer për rishqyrtim;

dh) ndryshimin e vendimeve të gjykatës së apelit dhe të gjykatës së shkallës së parë, dhe zgjidhjen përfundimisht të çështjes, kur zbatimi i ligjit procedural apo material nuk diktohet nga nevoja për rivlerësimin e fakteve apo të provave të çështjes;

e) lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit.

2. Në rastet kur Kolegji Penal ose Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vendosin njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, në vendim gjykata formulon edhe rregullin e së drejtës për çdo çështje të shtruar për zgjidhje në vendimin e ndërmjetëm të marrë gjatë gjykimit të çështjes. Në këtë rast, vendimi botohet në Fletoren Zyrtare.”.

Neni 37

Në nenin 491, shkronja “c” shfuqizohet.

Neni 38

Dispozitë kalimtare

1. Përbërja e trupave gjykues si dhe procedura e gjykimit në Gjykatën e Lartë rregullohet sipas përcaktimeve të këtij ligji, pavarësisht parashikimeve të ndryshme në ligje të tjera.

2. Rekurset e paraqitura, por ende të pashqyrtuara, konsiderohen të pranueshëm nëse plotësojnë parashikimet e ligjit në fuqi në kohën e depozitimit të tyre.

3. Çështjet që janë në kompetencën e Prokurorisë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Gjykatave kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, sipas përcaktimit të nenit 75/a përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, dhe që janë regjistruara përpara datës 1 qershor 2021, hetohen dhe gjykohen nga Prokuroria Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Gjykatat kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, pavarësisht ndryshimit të kompetencës lendore, sipas nenit 7 të këtij ligji.

Neni 39

1. Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, përveç sa është parashikuar në pikën 2, të këtij neni.
2. Neni 7 i këtij ligji, hyn në fuqi me 1 qershor 2021.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI